

1-9 janar, 24.704 udhëtarë me tragete drejt Italisë

10.01.2012



Që nga 1 janari i këtij viti afro 25 mijë udhëtarë janë nisur nga Durrësi me tragete drejt Italisë. Pjesa më e madhe e tyre janë bashkëatdhëtarë, të cilët po rikthehen pas festave të fundvitit në vendet e Evropës perëndimore ku jetojnë dhe punojnë prej vitesh.

Sipas të dhënave të Autoritetit Portual, gjatë 9 ditëve të para të vitit janë nisur me tragete drejt porteve të Barit, Ankonës dhe Triestes 24.704 udhëtarë me 5.644 autovetura gjithsej.

Vetëm të shtunën e kaluar, dita më e ngarkuar e këtij fillimviti, tragetet janë shfrytëzuar nga 6.198 udhëtarë me 1396 automjete gjithsej.

Sipas të dhënave paraprake të agjencive edhe sot në mbrëmje drejt portit të Barit do të lundrojnë katër tragete, të cilat pritet të transportojnë drejt Italisë mbi 2500 udhëtarë. Përveç një nate me mot të keq dhe det të trazuar, që detyroi shtyrjen e lundrimit të trageteve me disa orë, bashkëpunimi mes Forcave të Sigurisë Portuale, atyre të Policisë së Kufirit, Doganës dhe Kapitenerisë kanë mundësuar lëvizjen normale të udhëtarëve dhe mjeteve lundruese.

Një pjesë e bashkëatdhetarëve pas mbërritjes në portet italiane vijojnë më tej udhëtimin me automjete ose trena drejt qyteteve të Evropës ku punojnë dhe jetojnë.

